



Datë: 27.11.2025

Numër Protokolli: 7713/2025

A.nr.1840/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1840/2025 të datës 23.10.2025 të parashtruar nga ankuesja Y.K.R, nga Prishtina, kundër Vendimit të datës 26.09.2025 të Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa A.nr.1840/2025, e datës 23.10.2025 e parashtruar nga ankuesja Y.K.R.
- II. Anulohet** Vendimi Nr.363/2025 i datës 26.09.2025 nxjerrë nga Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore.
- III.** Njësia e Burimeve Njerëzore e ABGJ-së, Obligohet që të largojë masën disiplinore nga dosja e ankueses, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Obligohet** Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken **III** të dispozitivit.
- V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, Y.K.R (*tani e tutje referuar vetëm: Ankuesja*), më datë 23.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1840/2025 me numër protokolli:6954/2025, kundër Vendimit Nr.363/2025 të datës 26.09.2025 të nxjerrë

nga Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, përmes të cilit akt, ankueses i është shqiptuar masa disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.10.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për barazi Gjinore, ndërsa Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore më datë 06.11.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e datës 23.10.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 26.09.2025 të Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore; Akt Emërimit e ankueses të datës 18.08.2025; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2023; Vendimin për pushim i datës 15.09.2025; Vendimin për pushim i datës 29.08.2025; Kontratë e datës 18.06.2025; Raporti i projektit 01.09.2025; Vendimin e datës 17.06.2025 të Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore; E-mailin e datës 28.08.2025 dërguar nga D.Sh për ankuesen me korrespondencë e bashkangjitur; E-mailin e datës 28.08.2025 dërguar nga Y.K për D.Sh me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 26.08.2025 dërguar nga M.G për A.L dhe te tjerët; Shkresë “10425134 Subvencionet për entitete jopublike”; Urdhërpagesë e datës 10.09.2025; Urdhërpagesë e datës 03.07.2025; Urdhër obligim për pagesë i datës 03.07.2025; Urdhër për blerje i datës 02.07.2025; Vendimin e datës 30.05.2025; Shkresë e datës 26.06.2025 dërguar nga A.L për ankuesen; E-mailin e datës 30.06.2025 dërguar nga ankuesja për A.L; E-mailin e datës 01.07.2025 dërguar nga Sh.A për A.L dhe ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Kopjen e ID-së ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.10.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 06.11.2025; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është **e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës të ofruara nga palët në këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit Nr.320/2025 të datës 18.08.2025 mban pozitën e punës Shefe e Divizionit për Administratë, Buxhet dhe Financa, në kuadër të Agjencisë për Barazi Gjinore, ndërsa udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë, respektivisht Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore përmes Vendimit Nr.363/2025 të datës 26.09.2025 i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, me arsyetimin se e njëjta ka konsumuar elemente të shkeljes disiplinore të përcaktuara si në nenin 56 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafin 3, nën paragrafin 3.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër aktit të kontestuar pretendon se udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë, Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore masën e shqiptuar disiplinore e ka bërë me tendencë dhe pas asnjë provë bindëse, gjegjësisht e njëjta pretendon se vërejtja me shkrim i është shqiptuar pasi që ankuesja ia kishte komunikuar në zyrën e saj konfliktin e mundshëm të interesit lidhur me përfaqësuesen e OJQ-së Qendra Kosovare për Studime Gjinore, e cila njëherit ka qenë anëtare e komisionit

përzgjedhës për ndarjen e subvencioneve në ABGJ sipas Vendimit Nr.237/2025 të datës 30.05.2025, vendim ky i nënshkruar nga Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ, kanë zhvilluar aktivitete të përbashkëta të projektit së bashku me OJQ në PROGRAEK për periudhën Maj-Korrik 2025, tutje ankuesja pretendon se asnjëherë nuk ka pranuar një urdhër të shkruar apo kërkesë zyrtare nga Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, lidhur me çështjen në fjalë sa i përket ekzekutimit të pagesave për OJQ-në, në fjalë, ngase të gjitha detyrat e mia i kamë përfunduar në kohë, ndërsa shton faktin se vonesat kanë qenë për shkak se Zyrtarja Çertifikuese ka qenë në pushim nga data 01-05 shtator dhe se nuk mund të ekzekutohet asnjë pagesë pa përfunduar edhe procedura përkatëse nga Zyrtarja Çertifikuese, pozitë kjo e cila i raporton direkt Drejtoreshës Ekzekutive të ABGJ-së.

Po ashtu, ankuesja pretendon se sipas nenit 29 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik përcaktohet se: *“2. Në rastet kur zyrtarja/i publik dyshon për paligjshmërinë e urdhrin të mbikëqyrësit, ajo/ai nuk e zbaton urdhrin, por informon menjëherë mbikëqyrësen/in e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e mbikëqyrëses/it të personit që ka dhënë urdhrin. 3. Zyrtarja/i publik është i detyruar të zbatojë urdhrin e konfirmuar me shkrim, sipas paragrafit 2. të këtij neni, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale”*, ndërsa thekson faktin se në rrethanat e rastit konkret procedimi i lëndës pa i kompletuar dokumentacionin dhe pa përmbushur kërkesat ligjore përbën paligjshmëri, dhe me qëllim të mbrojtjes së ligjshmërisë nuk ka mundur të veprojë me pagesa pa fatura (sipas paragrafit 4 të kontratës Nr.267/2025 të datës 18.06.2025) të argumentuara nga OJQ përbën vepër penale, çka nuk e kam lejuar asnjëherë, sikurse e njëjta pretendon se dëshmi lidhur me sjelljen e saj me stafin dhe përmbushjen e detyrave dëshmohet edhe me formularët e vlerësimit të rezultateve të punës, të cilat i ka paparaqitur në cilësi të provës materiale. Tutja ankuesja pretendon se, nuk janë konsumuar asnjëra nga parakushtet ligjore të ligjit material, nenit 30 dhe 55 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik që e njëjta të jete përgjegjëse për shkelje disiplinore, kurse thekson faktin se Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, ka rënë ndesh me nenin 32 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik lidhur me veprimet për shmangien e konfliktit të interesit si dhe ka rënë ndesh me nenin 19 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit, si dhe nenin 8 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj si të bazuar, ndërsa të anulohet Vendimi i datës 26.09.2025 i Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë, kurse masa e shqiptuar disiplinore të largohet nga dosja personale.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses dhe me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike, fillimisht analizoi aktin e kontestuar, respektivisht Vendimin e datës 26.09.2025 të Drejtoreshës Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, dhe konstatoi se sipas aktit në fjalë, ankueses i është shqiptuar masë e lehtë disiplinore *“Vërejtje me shkrim”* e parashikuar nga neni 56 paragrafi 3, nënë paragrafi 3.3 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun”*, ku ndër tjerash Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, në cilësi të udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankueses, thekson faktin se ankuesja ka konsumuar shkelje nga neni 29 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“Zyrtarja/i publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me urdhrin e marrë nga mbikëqyrësja/i apo zyrtarja/i tjetër me kompetenca kontrolli ndaj saj/tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të institucionit”*, respektivisht është ndjerë e fyer pasi që ankuesja i ka thënë se nuk është përgjegjëgjësi e saj që t’i përgjigjet *“shoqeve të tua të cilat ti i financon”*, si dhe *“po ato janë shoqet e tua dhe ti i financon prandaj më dërgojnë mua emaile fyese”*, me ç’rast Drejtoresha Ekzekutive të Agjencisë, duke marrë përbazë parimin e

individualizmit të masave sikurse përcaktohet edhe me ligj, respektivisht shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj, si dhe ekzistencën e vërejtjeve të mëparshme të komunikuar sipas nenit 62 të ligjit. Tutje, nga analizimi i aktit të kontestuar, Kolegji i Këshillit konstatoi se po ashtu, ngjarja ndërlihet sipas përshkrimit si në arsyetimin e tij, me çështjen e financimit të OJQ-së RROGRAEK, çështje për të cilën ankuesja ka ngritur edhe pretendimet e saj ankimore pranë Këshillit.

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia për Barazi Gjinore përmes Kontratës/Memorandumit Nr.ref:267/2025, e ka financuar OJQ-në “Rrjeti i Organizatave të Grave Rome Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës”, në vlerën prej 10,000€ për zbatimin e Projektit “Gratë ndërtojnë paqe ndëretnike; Dialog e Fuqizim për komunitetet jo shumicë Rome, Ashkali dhe Egjiptase dhe Komunitetin shumicë Shqiptar në Prishtinë dhe Fushë Kosovë”, kurse komisioni përzgjedhës në përbërje prej 5 anëtarësh, ishte themeluar përmes Vendimit të datës 30.05.2025 nga Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, sikurse kjo e fundit po ashtu përmes Vendimit të datës 17.06.2025 e kishte themeluar Komisionin në përbërje prej tre anëtarësh, A.L, J.X dhe R.M, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të projektit të financuar sipas kontratës/memorandumit përkatëse.

Sipas provave të ofruara nga pala ankuese, kjo e fundit nga korrespondenca zyrtare dhe formularët e paraqitur kishte ndërmarrë veprimet procedurale, lidhur me ekzekutimin e pjesës ë parë të mjeteve në vlerë prej 3,000 Euro sipas Urdhërpagesës së Thesarit me datë 03.07.2025, mirëpo ajo çfarë bie në sy është se ankuesja para se të kryej ekzekutimi i mjeteve kishte kërkuar sqarime nga anëtarja e komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të projektit lidhur me buxhetin dhe një shumë të caktuar kontestuese, ashtu që në korrespondencën e përfaqësueses së organizatës në fjalë dhe zyrtares A.L-Kryesuese për mbikëqyrjen e zbatimit të projektit në fjalë vërehet se janë bërë korrigjime apo përmirësime në draft buxhetin përkatës (*çështje e konstatuar përmes provave, e-maileve të datës 30.06.2025 dërguar nga ankuesja për A.L, po ashtu emailit të datës 26.06.2025 dërguara nga D.Sh përfaqësuese e OJQ-së në fjalë, tek A.L dhe kjo e fundit me datë 26.06.2025 tek ankuesja*).

Po ashtu, edhe lidhur me kërkesat e përfaqësueses së OJQ-së në fjalë, të datës 28.08.2025 lidhur me mungesën e mjeteve për të përmbushur çështjen e pagave të stafit, ankuesja i kthen përgjigje si në **vijim, citoj**: “ *Pagesa e pjesës së dytë nuk është vonuar për arsye se unë personalisht jam në pushim ngase mjetet janë të zotuar për ju si shumë totale (sipas marrëveshjes me ABGJ-në) mirëpo raporti juaj financiar (transaksionet financiare dhe fatura nuk kanë qenë sipas kontratës që ju e keni dorëzuar në ABGJ) po ashtu edhe konfirmimet bankare nuk i keni sjellë të bashkangjitura me kontratat edhe pas një kohe që i kemi kërkuar; Jo nuk mundeni të huazoni mjete financiare për projektin të cilin e mbështet ABGJ-ja; Si divizion i financave në momentin që do e pranojmë të finalizuar raportin nga komisioni monitorues pagesa do ekzekutohet ”*, ndërsa në këtë komunikim apo njoftim ndaj OJQ-së përkatëse ka qenë e njoftuar apo mbajtur ne cc edhe Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së dhe anëtarët e komisionit mbikëqyrës për projektin përkatës. Tutje, Komisioni Mbikëqyrës për zbatimin e projektit në fjalë me datë 01.09.2025 kanë përgatitur Raportin Nr. i ref:245/2025 përmes të cilit konstatohet fakti se projekti në fjalë është zhvilluar sipas planit dinamik të paraparë me kontratën përkatëse, ndërsa sipas Urdhërpagesës së Thesarit shuma për pagesë prej 7,000 Euro është proceduar me datë 10.09.2025.

Po ashtu nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankueses i është konfirmuar e drejta në pushim mjekësor nga data 25 gusht -29 gusht 2025 (5 ditë), dhe po ashtu së njëjtës i është aprovuar edhe pushimi vjetore (3 ditë) nga data 01 shtator -03 shtator 2025 nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë, respektivisht Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, ndërsa sipas formularëve të vlerësimit rezultateve të punës për vitin 2023 (i datës 28.02.2024) ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme 4.6 (shkëlqyeshëm), kurse lidhur me fushën Efektiviteti në punë është vlerësuar me notë shkëlqyeshëm (5), komunikimi dhe përfaqësimi me notë shumë mirë (4), dhe Motivimi (zhvillimi) trajtimi i paanshëm i stafit me notë shumë mirë (4), e po ashtu sipas formularëve të vlerësimit rezultateve të punës për vitin 2024 (i datës 18.04.2025) ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme (Arrin pritshmërinë), kurse lidhur me fushën Respektimi i rregullave dhe procedurave është vlerësuar me notë (tejkalon pritshmëritë), për fushën bashkëpunimi dhe puna në ekip është vlerësuar me notën (Arrin pritshmëritë), dhe për fushën e Komunikimit efektiv është vlerësuar me notën (arrin pritshmëritë), ndërsa sipas legjislacionit të aplikueshëm, respektivisht nenit 9 paragraf 3, nën paragrafi 3.3 të Rregullore (Qrk) Nr. 26/2024 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, vlerësimi “Arrin pritshmëritë” ka këtë kuptim: “3.3.“Arrin pritshmërinë” është vlerësim që tregon se nëpunësi civil ka përmbushur me sukses të gjitha detyrat dhe kërkesat e vendosura për rolin e tij. **Performanca e tij/saj është në përputhje me objektivat e vendosura, sjelljes profesionale dhe sjelljes personale,**” dhe po ashtu sipas Rregullores Nr. 21/2020 Për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil Dhe Nëpunësve Të Shërbimeve Publike, nenit 11 paragrafi 1, nën paragrafit 1.4 e 1.5, dhe paragrafit 2, nën paragrafit 2. Ku përcaktohet se: “ Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “**shumë mirë**”; dhe Nga 4.5 deri në 5 nënkupton “**shkëlqyeshëm**”; “**shkëlqyeshëm**”, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë të gjitha pritjet. Gjithashtu nëpunësi ka kontribuar në masë të madhe në realizimin e objektivave të institucionit dhe në performancën e përgjithshme të institucionit; 2.2. “shumë mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”, gjegjësisht vlerësimi i rezultateve të punës për dy vitet përkatëse është bërë po nga Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së.

Kolegji i Këshillit sipas praktikës në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.10.2025 i është drejtuar Zyrtares së Lartë të Personelit, znj. F.B, ku ndër tjerash kishte kërkuar edhe provat si në vijim: “*Dëshmi nëse ankuesja ka pasur të shqiptuar masë disiplinore paraprakisht, apo nëse të njëjtës i është tërhequr vërejtja për performancë më të lartë; Dëshmi mbi bazën e të cilave ankuesja është gjetur përgjegjëse për shkëlqen e shqiptuar*”, mirëpo Këshilli me datë 06.11.2025 ka pranuar përgjigjen në fjalë të hartuar nga Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, përveç se nuk kishte arritur të siguronte apo dëshmonte provat e kërkuara si në kërkesën në fjalë të Kolegjit të Këshillit të datës 30.10.2025, kjo nuk është praktikë që institucionet e zgjedhin e as Agjencia për Barazi Gjinore në të kaluarën, e ku përveç tjerash, Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, duke marrë përbazë dispozitat e aplikuara të nenit 29 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 1.10 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata: 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij”, nuk është dashur të përfshihet në kthimin e përgjigjes, pasi që akti i kontestuar në Këshill ishte nxjerrë nga vet Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, ndërsa kjo e fundit në përgjigjen e dhënë për Këshillin me datë 06.11.2025, nuk kishte ofruara asnjë provë bindëse apo dëshmi shtesë përmes të cilave do të dëshmonte konstatimet e saja si në vendimin përmes të cilit ankueses i ishte shqiptuar

masa, respektivisht përgjigja e dhënë e datës 06.11.2025 ishte për nga përmbajtje e njëjtë me arsyetimin e aktit të kontestuar.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se në vlerësimin e terminologjisë juridike, ngritja nga stafi e një dukurie që mund të bie ndesh me çështjen e konfliktit të interesit në kuadër të të njëjtit institucion, nuk përbën në vete akt apo shkelje e cila mund të konsiderohet si sjellje jo e mirë apo jo etike ndaj eprorit apo kolegut dhe stafit në përgjithësi, pavarësisht mënyra se si fjalë artikullohet, madje Kolegji i Këshillit vlerëson se çështje të tilla sipas detyrës zyrtare duhet të trajtohen nga vetë Zyrtarët Kryesor Administrativ dhe të njëjtat duhet të trajtohen në rrugë përkatëse ligjore sipas kuadrit ligjor në fuqi, e tek pasi që situatat e tilla të sqarohen apo konstatohen nga organet kompetente sipas autorizimeve ligjore, më pastaj ka vend për të diskutuar dhe iniciuar eventualisht procedura disiplinore, kurse në rrethanat e rastit konkret shihet që një veprim i tillë nuk është ndërmarrë nga Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së, mirëpo e njëjta ka zgjedhur që për fjalët e thëna nga ankuesja sikurse janë pasqyruar të dy versionet e palëve në këtë kontest administrativ, t'i shqiptohet masa disiplinore "Vërejte me shkrim", sikurse, Kolegji i Këshillit po ashtu konstatoi se organi i punësimit në shkresën e dërguar nuk ka mundur të paraqes asnjë provë relevante dhe bindëse që ankuesja ka marr apo pranuar urdhër nga Udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë sikurse pretendohet në aktin e kontestuar duke iu referuar nenit 29 të LZP-së.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit, nuk ka mandatin dhe as autorizimet ligjore t'i sqaroj apo konstatojë apo të jap rekomandime, ngase sipas të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, organi kompetentë për trajtimin e çështjeve nga kjo fushë bie në kompetencë të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa palët e përfshira në procedurë i inkurajon dhe udhëzon që për çështjen përkatëse apo raste të ngjashme t'iu drejtohen organeve kompetente.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të marrë të gjitha së bashku në tërësi sikurse si dhe duke bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ ku përcaktohet edhe me nenin 89 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas analizimit të aktit të kontestuar, pas vlerësimit të shkresës së datës 06.11.2025 të organit të punësimit, erdhi në konstatimin se ankesa e ankueses e datës 23.10.2025 është e bazuar dhe gjen mbështetje ligjore, ngase në rrethanat e rastit konkret nuk është plotësuar asnjëri nga parakushtet ligjore të përcaktuara që një nëpunës civil të thirret në përgjegjësi disiplinore, sikurse përcaktohet me nenin 55 paragrafi 1 dhe nenin 29.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si: *"55.1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim; 29.1.Zyrtarja/i publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me urdhrin e marrë nga mbikëqyrësja/i apo zyrtarja/i tjetër me kompetenca kontrolli ndaj saj/tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të institucionit"*, pasi që organi i punësimit nuk ka arritur ta mbështes me prova dhe fakte bindëse asnjërin variant të konstatimit të tyre sikurse masën e shqiptuar disiplinore përmes Vendimit Nr.363/2025 të datës 26.09.2025.

Prandaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 8 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo”*, pasi që akti i nxjerr apo masa e shqiptuar nuk gjen mbështetje në dispozitat e ligjit të aplikuar material sikurse u sqarua dhe me lartë, Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së duke qenë edhe ZKA dhe e ka shfrytëzuar kompetencën ligjore që për çështjet e ngritura nga ankuesja që lidhen me çështjen e konfliktit të interesit, t’i shqiptoj masë disiplinore, kurse çështjet në fjalë nuk i ka adresuar në rrugë apo organe kompetente sikurse fyerjen nga ana e ankueses nuk ka mundur ta argumentojë me asnjë provë materiale, ndërsa aktit të kontestuar i mungon arsyetimi i qartë dhe ligjor që i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ, me shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim, nga rrjedh se një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, andaj mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, është anuluar Vendimi Nr.363/2025 i datës 26.09.2025 sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse masa e shqiptuara disiplinore është dhënë përmes aktit i cili është konstatuara si i paligjshëm dhe u anulua sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e ABGJ-së që të largojë masën disiplinore nga dosja e ankueses, nëse e njëjta është ekzekutuar apo vendos në dosjen e saj (përkundër që deri në përfundim të procesit të vendimmarrjes në këtë çështje nga këshilli nuk duhet të zbatohet masa disiplinore), sikurse parashihet në kompetencat edhe të kësaj të fundit me nenin 16 dhe 18 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1840/2025, datë 27/11/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, Y.K.R;
- Agjencisë për Barazi Gjinore (Drejtoreshës Ekzekutive dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.